



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 3131/7

Divjakë më 17/04 /2025

Lënda:

**RAPORT**

**“MBI TRANSPARENCËN NË VENDIMMARRJE TË KËSHILLIT BASHKIAK  
DIVJAKË PËR VITIN 2024”**

Të nderuar këshilltarë,

Këshilli i Bashkisë Divjakë, në kuadër të rritjes së efikasitetit të punës së tij, të rritjes së transparencës dhe kjo në konsultim të përhershëm dhe të vazhdueshëm me qytetarët, ka marrë një sërë nismash ndër të cilat janë përmirësimi i kuadrit rregullator dhe procedurial, përmirësimi i evidencave të punës së tij në raport me qytetarët, si dhe përmirësimi i vetmenaxhimit të këshillit etj. Në këtë kuadër është dhe përmirësimi i transparencës së aktiviteteve të këshillit, të mbledhjeve plenare të tij si dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje.

Duke u mbështetur dhe zbatuar Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenin 18”*Seancat e këshillimeve me bashkësinë*”, Këshilli Bashkiak Divjakë ka zhvilluar Konsultimet Publike me bashkësinë, dhe, për vitin 2024, janë zhvilluar 7 ( shtatë) konsultime dhe 19 ( nëntëmbëdhjetë) takime me komunitetin e Njësive Administrative të Bashkisë.

Janë zhvilluar këto konsultime publike:

- 1.Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Divjakë.
- 2.Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Divjakë ( Faza e parë)
- 3.Për miratimin e Planit vendor të Emergjencave civile 2024-2026 Bashkia Divjakë
- 4.Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Divjakë ( Faza e dytë)
- 5.Mbi diskutimin e paketës fiskale, për sistemin e taksave e tarifave vendore dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2025.
- 6.Mbi diskutimin e Strategjisë vendore për zvogëlimin e rriskut nga fatkeqësitë dhe planin e veprimit në territorin e Bashkisë Divjakë.
- 7.Mbi diskutimin e PBA 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025 Bashkia Divjakë.

Në këto takime këshilltarët janë njohur dhe kanë diskutuar bashkë me komunitetin, për problematika të ndryshme në lidhje me temat e mësipërme.

Këshilli i Bashkisë Divjakë si organ përfaqësues vendimmarrës dhe mbikqyrës ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse , duke respektuar parimet e demokracisë vendore, të transparencës për të qenë sa më afër qytetarëve.

Konsultimet publike janë realizuar në të gjitha Njësit Administrative të Bashkisë, ku gjatë vitit 2024 kanë marrë pjesë afërsisht 746 qytetarë nga të cilët 405 femra dhe 341 meshkuj të grupmoshave të ndryshme.

Në konsultimet e zhvilluara janë bërë propozime dhe sugjerime shumë të vlefshme, kryesisht për buxhetin dhe paketën fiskale. Këshilltarët dhe Bashkia kanë vlerësuar sugjerimet dhe propozimet e bëra nga qytetarët dhe janë angazhuar që ato të pasqyrohen në vendimarrje.

Buxheti i vitit 2025 është hartuar dhe miratuar duke përfshirë rekomandimet e bëra gjatë konsultimeve publike.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauduara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës së Bashkisë, me rastin e shqyrtimit të Projektvendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve në vitin 2024 u realizuan dhe u paraqitën në Këshill edhe disa informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të këshilltarëve.

Në planin e punës së KB për vitin 2024, si zë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm ishte dhe realizimi i trajnimeve të këshilltarëve. Për vitin 2024 u realizuan trajnimet e këshilltarëve nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), me këto tematika:

➤ Performanca, burimet njerëzore dhe Integrimi Evropian.

*Prezantim në PP, Vetëqeverisja vendore, rolet dhe funksionimi i Këshillit Bashkiak, Roli i këshillit bashkiak në mbikqyrjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të bashkisë, etj*

➤ Komisionet e Integritimit Evropian në Këshillat Bashkiak.

*Roli i Bashkive në Procesin e Integritimit në BE & Mbështetja e BE lidhur me zhvillimin ekonomik dhe social në nivel vendor; Roli i Këshillave Bashkiak në procesin e integritimit në BE etj.*

➤ Trajnimin e Komisioneve të Përhershme të Këshillave Bashkiak.

*Komisionet e përherëshme të këshillit të bashkisë, objekti i punës së komisioneve, funksionimi i komisioneve, roli i komisioneve në vendimmarrje, roli i komisioneve të përherëshme në konsultimin publik të këshillit etj.*

➤ Bashkitë në procesin e Integritimit Evropian të Shqipërisë, Roli i Këshillave Bashkiakë në procesin e Integritimit Evropian, Komisionet e Integritimit Evropian në Këshillat Bashkiak.

*Roli i Bashkive në procesin e integritimit në BE & mbështetja e BE lidhur me zhvillimin ekonomik dhe social në nivel vendor: - Roli i zyrtarëve të zgjedhur në procesin e anëtarësimit, hapat që duhet të ndërmerren për të siguruar angazhimin e Këshillave Bashkiakë në procesin e integritimit në BE në nivel vendor.*

Në këtë drejtim edhe për vitin 2025 në planin e aktiviteteve të miratuara janë planifikuar një sërë informacionesh dhe raportesh nga të cilat një pjesë e tyre, janë dhe detyrim ligjor për tu paraqitur nga administrata e bashkisë për informim Këshillit të Bashkisë.

Këshilli Bashkiak Divjakë, në kuadër të përmbushjes së qëllimit të tij, që konsiston në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve, ka përmirësuar mënyrat e komunikimit me qytetarët për të dërguar ankesat dhe kërkesat e tyre online, duke ju kursyer kohë dhe duke marrë në konsideratë kërkesën apo ankesën për shqyrtim sipas Rregullores së Brendëshme të Këshillit Bashkiak.

Bashkëpunimi i Këshillit Bashkiak Divjakë në tërësi me ekzekutivin, Kryetarin e Bashkisë ka qenë maksimal duke bërë që punët për zhvillimin e Bashkisë Divjakë si dhe të gjithë Njësie Administrative të saj, të ecin me ritmin e duhur.

Ju faleminderit!



**KRYESIA E KËSHILLIT TË BASHKISË**

1. Anna Nalio

2. Sen' Bete

3. Shpejtim Gheski

4. \_\_\_\_\_

5. \_\_\_\_\_